



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/35
Datë: 19.02.2026

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 43 i Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Marrëveshjen e partneritetit IPA/2023/450-172 ndërmjet përfituesve të projektit “EFFORT- Enhancing Facilities for a Future with an Optimal Resource and Energy Efficiency Trajectory” kontratës së Grantit IPA/2023/450-172 “EFFORT” financuar nga Bashkimi Evropian si dhe bazuar në Paragrafin 5.5 të Manualit të Programit; Normativës së Bashkimit Evropian mbi prokurimet publike për nënshkrimin e kontratave për shërbime, furnizime dhe punime për Interreg – IPA CBC siç përcaktuar në artikullin 45 të Rregullores 447/2014 mbi rregullat specifike për implementimin e Rregullores (EU) 231/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për ngritjen e instrumenteve të asistencës të Para-anëtarësimit (IPA III); të Kapitullit 3 Titulli IV Pjesa e Dytë e Rregullores (EU, Euratom) Nr. 966/2012 dhe Kapitullit 3 Titulli II Pjesa e Dytë e Rregullores të Deleguar (EU) Nr. 1268/2012; Parashikimet e Udhëzuesit “PRAG”, Kryetari i Komunës me datë: 19.02.2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Ngritjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave për tenderin : “ Punime Ndërtimi për Zbatimin e Masave të Efiçencës së Energjisë (EE) në Ndërtesat Publike”
2. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të përbëhet nga:
 - Florije Shehu – Kryetar i Komisionit (pa të drejtë nënshkrimi)
 - Iliriana Isufaj – Sekretar i Komisionit (pa të drejtë nënshkrimi)
 - Zenun Shala – vlerësues
 - Ferdone Tofaj – vlerësues
 - Arian Xhuli – vlerësues
3. Grupi i Komisionit të vlerësimit do të ndjekë procesin e vlerësimit të ofertave duke filluar nga data limit e paraqitjes së ofertave, datë 24.02.2026 të përcaktuar në dokumentet standard të tenderimit, si dhe të ndjekë procedurat e nevojshme për shpalljen e fituesit dhe lidhjen e mëtejshme të kontratës së punëve.
4. Buxheti maksimal për këtë tender do të jetë 449,700.00 (katërqind e dyzet e nëntë mijë e shtatëqind) Euro.
5. Ngarkohen anëtarët e Komisionit të Vlerësimit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës